



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 107

24 gusht

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 441, datë 11.7.2012	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit/patentave të shoferëve.....	5947
Vendim i KM nr. 442, datë 11.7.2012	Për miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF 011576 të Fondit Suedez të Mirëbesimit, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve të siguruar nga Suedia, për të financuar projektin e përmirësimit të administrimit të burimeve natyrore.....	5951
Vendim i KM nr. 443, datë 11.7.2012	Për miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF 011176, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, si administratore të Fondit të Besimit Multidonator për lehtësimin e qeverisjes me partneritet, për financimin e projektit “Mbështetja për rritjen e sigurisë së sistemit të prokurimit elektronik në Shqipëri”.....	5958
Vendim i KM nr. 446, datë 11.7.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 532, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacione ushtarake në shtabe të ndryshme në Afganistan”, të ndryshuar.....	5967
Vendim i KM nr. 447, datë 11.7.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 197, datë 16.3.2011 të Këshillit të Ministrave “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak ndërkombëtar KFOR, Kosovë”, të ndryshuar.....	5967
Vendim i KM nr. 448, datë 11.7.2012	Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të emërimit të institucionit privat të arsimit të lartë “New York University of Tirana”.....	5968

Vendim i KM nr. 449, datë 11.7.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, të ndryshuar.....	5968
Vendim i KM nr. 450, datë 11.7.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 289, datë 17.5.2006 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI)”, të ndryshuar.....	5970
Vendim i KM nr. 458, datë 25.7.2012	Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Lenie, z. Astrit Bici.....	5970
Vendim i KM nr. 462, datë 11.7.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1188, datë 20.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për importimin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve”.....	5971
Vendim i KM nr. 463, datë 18.7.2012	Për një shtesë në vendimin nr. 1351, datë 3.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike metrologjike të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara”..	5973
Vendim i KM nr. 514, datë 1.8.2012	Për shpërblimin e pronarëve për sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale....	5978

VENDIM
Nr. 441, datë 11.7.2012

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR NJOHJEN E NDËRSJELLË TË LEJEVE TË DREJTIMIT/PATENTAVE TË SHOFRERËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit/patentave të shoferëve, sipas tekstit dhe ankeseve bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS MBI NJOHJEN E NDËRSJELLË TË LEJEVE TË DREJTIMIT/PATENTAVE TË SHOFRERËVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (në vijim të quajtura “palë kontraktuese”),
me dëshirën të përmirësojnë sigurinë rrugore;
si dhe të lehtësojnë qarkullimin rrugor në territoret e palëve kontraktuese;
të vendosur të promovojnë bashkëpunimin në sektorin e transportit dhe qarkullimin rrugor;
bien dakord për sa vijon:

Neni 1

Palët kontraktuese do të njohin në mënyrë të ndërsjellë, për qëllim qarkullimi në territoret e tyre, lejet e drejtimit/patentat e shoferëve kombëtare të rregullta, të lëshuara nga autoritetet kompetente të palës tjetër kontraktuese, brenda afatit të tyre të vlefshmërisë, sipas kuadrit të tyre të brendshëm ligjor.

Neni 2

1. Palët kontraktuese do të njohin në mënyrë të ndërsjellë kategoritë e lejeve të drejtimit/patentat e shoferëve mbi bazën e tabelave teknike të barasvlershmërisë, sipas kësaj marrëveshjeje, pjesë përbërëse të së cilës ato janë.

Këto tabela, së bashku me një listë të modele të lejeve të drejtimit/patentave të shoferëve, përbëjnë bashkëlidhjet teknike që mund të ndryshohen nga autoritetet kompetente të palëve kontraktuese me një shkëmbim notash verbale.

2. Autoritetet qendrore kompetente për verifikimin e lejeve të drejtimit/patentave të shoferëve, nëse do të jetë e nevojshme, janë si vijon:

2.1 Në Republikën e Shqipërisë: Ministria e Punëve Publike dhe Transportit – Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, rruga “Irfan Tomini” – Tiranë, tel/fax +355 4 2238175.



2.2 Në Republikën e Kosovës: Ministria e Punëve të Brendshme – Agjencia për Regjistrim Civil, rruga objekti ish-Ndërtesa Gërmis, kati përdhes, nr. 10000, Prishtinë; tel/fax + 381 38 200 19 114/ +381 38 200 19 020.

Neni 3

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin palët kanë njoftuar njëra-tjetrën nëpërmjet rrugëve diplomatike se janë përbushur kërkesat e tyre të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Kjo marrëveshje do të përfundojë për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Secila palë kontraktuese mund të denoncojë këtë marrëveshje në çdo kohë për palën tjetër kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në raste të tilla, denoncimi do të ketë efekt 6 (gjashtë) muaj nga data e marrjes së këtij njoftimi.

3. Çdo diskutim lidhur me interpretimin ose aplikimin e kësaj marrëveshjeje do të caktohet pas konsultimeve dhe negociatave ndërmjet dy palëve kontraktuese.

4. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet pas miratimit të shkruar të ndërsjellë të palëve kontraktuese. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

5. Bërë në Tiranë, më 12 qershor 2012, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë autentike. Në rast të mosmarrëveshjeve në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

ANEKSE

Për marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës mbi njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit/patentave të shoferëve

Modelet e lejeve të drejtimit/patentave të shoferëve
Tabelat e ekuivalencës

ANEKSI 1

MODELET E LEJEVE TË DREJTIMIT/PATENTAVE TË SHOFRERËVE

Modelet e lejeve të drejtimit të lëshuara në Republikën e Shqipërisë


Një model i lejes së drejtimit karte (card), lëshuar në Shqipëri që nga data 1 korrik 2005

Një model i lejes së drejtimit prej letre, i vlefshëm nga data 1 nëntor 1999

Modelet e patentave të shoferëve të lëshuara në Republikën e Kosovës

Një model patente shoferi prej letre, lëshuar në Kosovë që nga data 13 nëntor 2008

I. Model i lejes së drejtimit, lëshuar në Republikën e Shqipërisë deri në datë 1 korrik 2005



Nr. 930810

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHËRBIMEVE
TE TRANSPORTIT BRUGOR

DESHMI AFTESIE

EMRI _____

MBIEMERI _____

ATËSIA _____


DATE LINDJA _____

VENDLINDJA _____

VENDBANIMI _____

NENSHKRIIMI I TITULLARIT TE AUTORIZUAR _____

me _____



PER DREJTIM
AUTOMJETESH



Nr. 930810...

LLOJI I DESHMISE SE AFTESISE		KOHA E LESHIMIT	FIRMA, VULA
A	Motoçikletë me peshë deri 400 kg	Data	
		Prot. Nr.	
B	Automjete, përposhja A, me peshë me ngarkesë të plotë 3500 kg, ose me fuqi vende, tërësisht drejtues	Data	
		Prot. Nr.	
C	Automjete për transport mallrash me ngarkesë të plotë më 3500 kg	Data	
		Prot. Nr.	
D	Automjete për transport personash me më shumë vende përposhja drejtues	Data	
		Prot. Nr.	
E	Automjete të kategorisë B, C dhe D, për të cilat detyrohet çelësi afësisht për drejtues me rimorkio të lehtë	Data	
		Prot. Nr.	
F	Traktorë me rrotë gomë të këmbës me rimorkio me peshë me ngarkesë të plotë jo më të madhe se peshë e rimorkios	Data	
		Prot. Nr.	



SHËNOTIM: Automojetve të kategorive A, B, C dhe D mund t'u bëhet propozim me rimorkio të lehtë, me kusht që përkatësimi B është i kufizuar me rimorkio të ngarkesë të plotë, me kategori B.



II. Model i lejes së drejtimit, lëshuar në Republikën e Shqipërisë që nga data 1 korrik 2005



III. Model i patentës së shoferit, lëshuar në Republikën e Kosovës nga data 13 nëntor 2008



ANEKSI 2
TABELAT E EKUIVALENCËS

I. Lejet e drejtimit, lëshuar në Republikën e Shqipërisë deri më 1 korrik 2005

KATEGORITË
A
B
C
D
E
F

II. Lejet e drejtimit, lëshuar në Republikën e Shqipërisë nga 1 korrik 2005

KATEGORITË
A
B
C
D
BE
CE
DE

III. Patentat e shoferëve, lëshuar në Republikën e Kosovës nga data 13 nëntor 2008

KATEGORITË
A1
A
B1
B
C1
C
D1
D
BE
C1E
CE
D1E
DE
M
L
T

VENDIM
Nr. 442, datë 11.7.2012

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF 011576 TË FONDIT SUEDEZ TË MIRËBESIMIT, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE TË SIGURUARA NGA SUEDIA, PËR TË FINANCUAR PROJEKTIN E PËRMIRËSIMIT TË ADMINISTRIMIT TË BURIMEVE NATYRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Për miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF 011576 të Fondit Suedez të Mirëbesimit, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve të siguruara nga Suedia, për të financuar projektin e përmirësimit të administrimit të burimeve natyrore sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Banka Botërore	1818 H Street N.W.	(202) 477-1234
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim	Washington, D.C. 20433	Adresa kabllore: INTBAFRAD
Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim	U.S.A.	Adresa kabllore: INDEVAS

maj 2012

Shkëlqesia e tij Ridvan Bode
Ministër i Financave
Ministria e Financave
BLVD. "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri
Lënda: Granti nr. TF011576 nga Fondi Suedez i Besimit
Projekti i përmirësimit të administrimit të burimeve natyrore
I nderuar Shkëlqesi,

Në përgjigje të kërkesës për asistencë financiare të bërë në emër të Shqipërisë (marrësi), kam kënaqësinë t'ju informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), në cilësinë e administratorit të fondeve në formë granti të dhëna nga Suedia, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (donatori), propozon t'i japë marrësit një grant me vlerë jo më të madhe se dy milionë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëzet e shtatë dollarë amerikanë e pesëdhjetë cent (2.716.027,50 US\$) (granti) sipas kushteve të parashikuara ose të përmendura në këtë letër-marrëveshje (Marrëveshja), e cila përfshin aneksin bashkëlidhur, për të asistuar në financimin e projektit të përshkruar në aneks (projekti).

Ky grant mbështet nga fondi i besimit i lartpërmendur, për të cilin Banka Botërore merr kontribute periodike nga donatori. Sipas seksionit 3.02 të kushteve standarde (të parashikuara në aneksin e kësaj Marrëveshjeje), detyrimet e Bankës Botërore për të kryer pagesë në lidhje me këtë Marrëveshje nuk shkojnë përtej shumës së fondeve, të cilat ia ka vënë në dispozicion donatori në kuadër të fondit të besimit të lartpërmendur dhe e drejta e marrësit për të tërhequr fonde nga granti varet nga gatishmëria e fondeve në fjalë. Kështu, nëse donatori, për çfarëdo arsye, i anulon ose nuk i paguan Bankës Botërore kontributet në kuadër të fondit të besimit, ose nëse si pasojë e luhatjeve të kursit të këmbimit valuator, shuma e fondeve të gatshme në fondin e besimit nuk është e mjaftueshme për qëllimet e grantit, Marrësi mbulon riskun e mungesës së fondeve në fjalë dhe Banka Botërore nuk mban asnjë përgjegjësi përpara Marrësit ose palëve të treta në lidhje me shpenzime a detyrime që i lindin marrësit ose palëve të treta në lidhje me këtë Marrëveshje, të cilat tejkalojnë sasinë e fondeve të vëna në dispozicion të Bankës Botërore nga donatori për qëllimet e grantit.

Me konfirmimin e miratimit të vet, më poshtë, marrësi deklaron se është i autorizuar të lidhë këtë Marrëveshje dhe të realizojë projektin sipas kushteve të parashikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje.

Ju lutem konfirmoni aprovimin e marrësit për sa më lart, përmes vendosjes së nënshkrimit dhe datës mbi kopjen e bashkëlidhur të kësaj Marrëveshjeje nga një zyrtar i autorizuar i marrësit, dhe t'ia

ktheni kopjen në fjalë Bankës Botërore. Pas marrjes nga Banka Botërore të kopjes së sigluar, kjo Marrëveshje hyn në fuqi pasi Banka Botërore merr njoftimin nga marrësi për përfundimin e procedurave të saj të brendshme, me kusht që oferta për këtë Marrëveshje të tërhiqet nëse Banka Botërore nuk merr kopjen e sigluar dhe njoftimin përkatës brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve pas ditës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga Banka Botërore, përveç rasteve kur Banka Botërore vendos një datë të mëvonshme për këtë qëllim.

Me respekt,
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
Nga: Jane Armitage

Drejtoreshë Vendi, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore
Miratoi:
Për Shqipërinë
Nga: Përfaqësues i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

Datë: _____

Bashkëlidhjet:

1. Kushtet standarde për grantet që jep Banka Botërore në kuadër të fondeve të ndryshme, datë 31 korrik 2010.

2. Letër disbursimi me të njëjtën datë me atë të kësaj Marrëveshjeje, së bashku me udhëzimin e Bankës Botërore për disbursimin e fondeve të projektit, datë 10 maj 2006.

Granti i SIDA-s nr. TF011576

ANEKS

Neni 1

Kushtet standarde, përkufizime

1.01 Kushtet standarde. Kushtet standarde për grantet që jep Banka Botërore në kuadër të fondeve të ndryshme, datë 31 korrik 2010 (kushtet standarde) janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përkufizime. Nëse nuk kërkohet ndryshe nga konteksti, termat që fillojnë me gërmë kapitale në këtë Marrëveshje kanë kuptimin e vendosur për to në kushtet standarde ose në këtë Marrëveshje:

a) "Përfituesi" është marrësi i nënprojekteve në kuadër të skemës së granteve për administrimin e zonave ujëmbledhëse;

b) "KAM" është Kuadri i Administrimit Mjedisor, i pranueshëm për Bankën Botërore, i datës 24 shkurt 2005 dhe i rishikuar në dhjetor 2011, në të cilin parashikohen procedurat dhe masat për zbatimin e ndikimeve të pafavorshme në mjedis, me shtesat dhe ndryshimet që mund t'i bëhen me pëlqimin e Bankës Botërore;

c) "MOG" është Manuali Operativ i Granteve, ku përshkruhen procedurat për vënien në zbatim të granteve për administrimin e zonave ujëmbledhëse të përmendura në pikën iv të paragrafit 2.01 dhe shkronjën "e" të paragrafit 2.02 të aneksit, i cili duhet miratuar nga marrësi dhe duhet të jetë i pranueshëm për Bankën duke përfshirë, ndër të tjera: a) procedura dhe sisteme kontrolli të mjaftueshme për sa i përket përmbushjes së kushteve, vlerësimit, përzgjedhjes, prokurimit dhe fluksit të fondeve për grantet, me qëllim që të garantohet që fondet të përdoren për qëllimet e synuara; dhe b) masa mbrojtëse mjedisore dhe sociale të mjaftueshme;



d) “Skema e granteve” është skema e granteve konkurruese për nënprojektet e administrimit të zonave ujëmbledhëse, të cilat marrësi ia jep secilit përfitues sipas MOG-së;

e) “Kostot operative” janë kostot që lindin në kuadër të projektit dhe përfshijnë: i) mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës dhe të automjeteve; ii) pagat që u jepen punonjësve, me përjashtim të pagave të nëpunësve civilë të marrë për qëllimin e projektit; iii) transporti dhe udhëtimet, duke përfshirë kuotat e dietave për punonjësit e projektit të marrësit me statusin e udhëtimit; iv) materiale zyre, shërbime dhe administrim i zyrës, duke përfshirë edhe shërbime përkthimi, shtypi dhe publiciteti; v) kostot e lëndëve djegëse; vi) kostot e komunikimit; dhe vii) çdo kosto tjetër për mbështetjen e administrimit të projektit, për të cilat bihet dakord herë pas here nga marrësi dhe Banka Botërore, por duke përjashtuar pagat e nëpunësve civilë të marrësit;

f) “MZP” është manuali i zbatimit të projektit, i përmendur në shkronjën “f” të paragrafit 2.02 të aneksit të kësaj Marrëveshjeje, të miratuar nga huamarrësi më 25 prill 2005 dhe të përditësuar më 26 dhjetor 2011, ku parashtrihen procedurat operative dhe administrative për vënien në zbatim të projektit, përfshirë prokurimin, drejtimin financiar, livrimin, kontabilitetin, kërkesat për auditimin, monitorimin dhe vlerësimin, me shtesat dhe ndryshimet që mund të bëhen herë pas here, të pranueshme për Bankën;

g) “Nënprojekti” është një nënprojekt i përzgjedhur dhe i aprovuar nga marrësi për t’u financuar me grantin për administrimin e zonave ujëmbledhëse, sipas kritereve dhe procedurave të parashikuara në MOG;

h) “Granti i nënprojektit” është ofrimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve të konsulencës, të financuara me mjetet e grantit për nënprojektin e përzgjedhur dhe aprovuar nga marrësi;

i) “Trajnim dhe seminar pune” janë shpenzimet që i lindin huamarrësit në lidhje me kryerjen e veprimtarive të trajnimit, seminareve të punës dhe vizitave studimore në kuadër të projektit, duke përfshirë kostot e udhëtimit dhe dietat për pjesëmarrësit në trajnim, instruktorët e trajnimit dhe pjesëmarrësit në seminarët e punës, marrjen me qira të mjedisëve e shërbimeve dhe pajisjet dhe materialet e trajnimit dhe materialet e tjera të lidhura me këto;

j) “Granti për administrimin e zonës ujëmbledhëse” është granti që marrësi i ka dhënë ose do t’i japë secilit prej pjesëmarrësve në kuadër të marrëveshjes për grantin për administrimin e zonës ujëmbledhëse; dhe

k) “Marrëveshja për grantin për administrimin e zonës ujëmbledhëse” është marrëveshja e lidhur ndërmjet marrësit dhe secilit përfitues, sipas kushteve të parashikuara në paragrafin 2.03 të këtij aneksi, me shtesat dhe ndryshimet që mund t’i bëhen Marrëveshjes herë pas here nga palët, të pranueshme për Bankën.

Neni 2

Realizimi i projektit

2.01 Objektivat dhe përshkrimi i projektit. Objektivi i projektit është dhënia e mbështetjes së vazhdueshme për administrimin e përmirësuar, të bazuar në komunitet të burimeve natyrore në zonat e larta dhe malore me tendencë erozioni në Shqipëri, përmes investimeve dhe planifikimit me pjesëmarrje dhe përgatitja e projektit të propozuar të shërbimeve mjedisore (ESP). Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

i) Mbështetje për përshkallëzimin e përgatitjes së planeve të administrimit, me pjesëmarrje të kullotave dhe pyjeve dhe të planeve të mikorzonave ujëmbledhëse, të mbështetura tashmë në kuadër të projektit të zhvillimit të burimeve natyrore (NRDP);

ii) Mbështetje për përshkallëzimin e zbatimit të punimeve në fushën e kullotave dhe pyjeve, sekuestrimit të gazeve të karbonit dhe mikorzonave ujëmbledhëse, të mbështetura tashmë në kuadër të projektit të zhvillimit të burimeve natyrore (NRDP);

iii) Mbështetje për përgatitjen e projektit të propozuar të shërbimeve mjedisore;

iv) Zbatimin e skemave pilot të granteve konkurruese për administrimin e zonave

ujëmbledhëse për të mbështetur masat dhe zonat e synuara të identifikuar në MOG për masat agro-mjedisore dhe qasjet për agro-mjedisin, të bazuara në komunitet; dhe

v) Mbështetje për ekipin e menaxhimit të projektit për zbatimin e aktiviteteve të lartpërmendura.

2.02 Realizimi i projektit në përgjithësi. Marrësi deklaron angazhimin e tij për objektivat e projektit. Për këtë qëllim, marrësi e realizon projektin nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave sipas dispozitave të: a) nenit 2 të kushteve standarde; b) “Udhëzimit për parandalimin dhe luftën kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit në projektet e financuara me hua të BNRZH-së dhe kredi e grante të SHNZH-së, datë 15 tetor 2006, rishikuar në janar 2011 (“Udhëzimi kundër korrupsionit”); c) këtij neni II; d) KAM-së; e) MOG-së; f) MZP-së; dhe g) Marrëveshjes për grantin për administrimin e zonës ujëmbledhëse.

2.03 Masat organizative institucionale dhe të tjera. a) Për të mundësuar realizimin e projektit, marrësi ia vendos në dispozicion fondet e grantit secilit përfitues sipas një marrëveshjeje granti për administrimin e zonës ujëmbledhëse të lidhur ndërmjet marrësit dhe përfituesit, sipas kushteve të aprovuara nga Banka Botërore. Marrësi i ushtron të drejtat që rrjedhin nga Marrëveshja për grantin për administrimin e zonës ujëmbledhëse, në mënyrë të tillë që të mbrojë interesat e marrësit dhe të Bankës Botërore dhe të përmbushë qëllimet e grantit. Nëse nuk bie dakord ndryshe Banka, marrësi nuk e delegon, ndryshon, shfuqizon ose heq dorë nga marrëveshja e grantit për administrimin e zonës ujore apo dispozita të saj.

2. Marrësi kujdeset që nënprojekti i zbatuar nga përfituesi në kuadër të marrëveshjes së grantit për administrimin e zonës ujëmbledhëse, të respektojë dispozitat e KAM-së, MOG-së dhe MZP-së.

2.03 Vizibiliteti publik dhe vizitat e donatorit. a) Marrësi merr ose kujdeset që të merren të gjitha masat që mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme Banka Botërore, për të identifikuar publikisht mbështetjen e donatorit për projektin.

b) Në kuptim të seksionit 2.09 të kushteve standarde, marrësi, me kërkesën e Bankës Botërore, merr të gjitha masat që kërkohen nga ana e tij, për t’u dhënë mundësi përfaqësuesve të donatorit të vizitojnë çdo pjesë të territorit të marrësit për qëllime të lidhura me projektin.

2.04 Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi për projektin. a) Marrësi monitoron dhe vlerëson ecurinë e projektit dhe përgatit raportet e projektit sipas dispozitave të seksionit 2.06 të kushteve standarde dhe në bazë të treguesve të parashikuar më poshtë, në paragrafin “b” të këtij seksioni. Secili raport-projekt mbulon një periudhë 6 (gjashtë) mujore dhe i dorëzohet Bankës Botërore jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës që mbulon raportin.

b) Treguesit e ecurisë së përmendur më lart në paragrafin “a” përbëhen nga sa më poshtë:

i) brenda datës 28 shtator 2012, të jenë përgatitur dhe aprovuar planet e administrimit, me pjesëmarrje të pyjeve dhe kullotave dhe planet e mikrozonave ujëmbledhëse;

ii) brenda datës 28 dhjetor 2012 të jenë vendosur masat e zvogëlimit të erozionit në 30.000 hektarë pyje dhe tokë bujqësore, duke sjellë një zvogëlim të erozionit prej 90.000 tonë;

iii) brenda datës 31 tetor 2012 të ketë përfunduar përgatitja e projektit të propozuar të shërbimeve mjedisore;

iv) brenda datës 28 shtator 2012 të jetë realizuar projektligji për pyjet, sistematizimi i shërbimit të shtrirjes, rishikimi i shpenzimeve publike, rishikimi operativ i projektit të zhvillimit të burimeve natyrore dhe trajnimet dhe seminarët e punës;

v) brenda datës 28 dhjetor 2012 të jenë realizuar një numër skemash granti.

vi) brenda datës 28 dhjetor 2012 të jetë përgatitur dhe aprovuar raporti i progresit, raporti i drejtimit financiar, plani i prokurimit dhe raporti i monitorim-vlerësimit.

c) Marrësi përgatit raportin e përfundimit sipas dispozitave të seksionit 2.06 të kushteve standarde. Raporti i përfundimit i dorëzohet Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së mbylljes.

2.05 Drejtimi financiar. a) Marrësi kujdeset që të mbahet një sistem i drejtimit financiar sipas dispozitave të seksionit 2.07 të kushteve standarde.

b) Marrësi kujdeset që të përgatiten dhe t’i dorëzohen Bankës Botërore, si pjesë e raportit të



projektit, raportet financiare të ndërmjetme të paaudituar, jo më vonë se një muaj pas mbylljes së çdo tremujori kalendarik, duke mbuluar tremujorin, me formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën Botërore.

c) Marrësi merr masat që pasqyrat financiare të lartpërmendura të auditohen sipas dispozitave të seksionit 2.07 të kushteve standarde. Secili auditim i tillë i pasqyrave financiare mbulon periudhën e një viti fiskal të marrësit. Pasqyrat financiare të audituara për secilën periudhë i dorëzohen Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas mbylljes së periudhës në fjalë.

2.06 Prokurimi

a) Të përgjithshme. Të gjitha mallrat, punimet, shërbimet jo të konsulencës dhe shërbimet e konsulentëve, që janë të nevojshme për projektin dhe që duhen financuar me fondet e grantit, prokurohen sipas kërkesave të parashikuara ose të përmendura në:

i) Seksionin I të udhëzimeve për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokosulente në kuadër të huave të BNRZH-së dhe kredive e granteve të SHNZH-së nga huamarrësit e Bankës Botërore, i muajit janar 2011 (udhëzime për prokurimin), në rastin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente;

ii) Seksionet I dhe IV të udhëzimit për përzgjedhjen dhe punësimin e konsulentëve në kuadër të huave të BNRZH-së dhe kredive e granteve të SHNZH-së nga huamarrësit e Bankës Botërore, i muajit janar 2011 (udhëzimi për konsulentët), në rastin e shërbimeve të konsulentëve; dhe

iii) dispozitat e këtij seksioni, si ato që zhvillohen në planin e prokurimit të përgatitur dhe të përditësuar herë pas here nga marrësi sipas paragrafit 1.18 të udhëzimit për prokurimin dhe paragrafit 1.25 të udhëzimit për konsulentët (plani i prokurimit).

b) Përkufizime. Termat që fillojnë me shkronja kapitale e që përdoren në pikat e mëposhtme të këtij seksioni, për të përshkruar metoda të caktuara prokurimi ose metodat e shqyrtimit nga Banka Botërore për kontrata të veçanta, mbështeten në metodën përkatëse të përshkruar, sipas rastit, në seksionin II dhe seksionin III të udhëzimeve për prokurimin ose në seksionet II, III, IV dhe V të udhëzimeve për konsulentët.

c) Metodatat e veçanta të prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente:

i) Për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente për kontratat e përcaktuara në planin e prokurimit mund të përdoren metodat e mëposhtme: A) blerje në treg; B) kontraktim i drejtpërdrejtë; dhe C) procedurat e pjesëmarrjes së komunitetit, të cilat janë konstatuar si të pranueshme nga Banka Botërore;

d) Metodatat e veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve:

i) Nëse nuk parashikohet ndryshe në pikën (ii) më poshtë, shërbimet e konsulentëve prokurohen me kontrata të lidhura në bazë të përzgjedhjes sipas cilësisë dhe koston;

ii) Për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për kontratat e përcaktuara në planin e prokurimit mund të përdoren metodat e mëposhtme: A) Përzgjedhje me buxhet të përcaktuar; B) Përzgjedhje me koston më të ulët; C) Përzgjedhje e bazuar në kualifikimet e konsulentëve; D) Përzgjedhje me një burim i firmave të konsulencës; E) Përzgjedhje e konsulentëve individë; dhe F) Procedurat me një burim për përzgjedhjen e konsulentëve individë.

e) Shqyrtimi i vendimeve të prokurimit nga Banka Botërore. Plani i prokurimit parashikon kontratat, të cilat do t'i nënshtrohen shqyrtimit paraprak nga Banka Botërore. Të gjitha kontratat e tjera i nënshtrohen shqyrtimit të mëpasshëm nga Banka Botërore.

Neni 3

Tërheqja e fondeve të grantit

3.01 Shpenzimet që plotësojnë kushtet. Marrësi mund t'i tërheqë fondet e grantit sipas dispozitave të: a) kushteve standarde; b) këtij seksioni; dhe c) udhëzimeve të tilla shtesë që mund të japë Banka Botërore duke ia njoftuar marrësit (duke përfshirë edhe "Udhëzimin e Bankës Botërore për lëvrimin e projekteve", të muajit maj 2006, me rishikimet e herëpashershme që mund t'i japë Banka Botërore dhe të zbatueshme për këtë Marrëveshje sipas këtyre udhëzimeve), për të financuar 5956

shpenzimet që i plotësojnë kushtet, të parashikuara në tabelën në vijim. Në tabelë përcaktohen kategoritë e shpenzimeve që i plotësojnë kushtet e të cilat mund të financohen me fondet e grantit (kategoria), shpërndarjet e shumave të grantit për secilën kategori dhe përqindja e kritereve për identifikimin dhe përzgjedhjen e nënprojekteve dhe politikave sipas të cilave nënprojektet do të vihen në zbatim me shpenzime që i përmbushin në secilën kategori:

Kategoria	Shuma e shpërndarë e grantit (shprehur në USD)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë tatimet)
1. Mallrat, punimet civile, shërbimet e konsulentëve dhe trajnime e seminare pune	2.388.836,50	95%
2. Kostot operative shtesë	271.602	89%
3. Skema e grantit	55.589	100% e grantit të nënprojekteve e livruar
SHUMA TOTALE	2.716.027,50	

3.02 Kushtet për tërheqjen. Pavarësisht nga dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, nuk mund të bëhet asnjë tërheqje:

- a) për pagesat e kryera nga marrësi përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje; ose
- b) për shpenzimet në kategorinë (3), nëse marrësi nuk ka miratuar MOG, që është i pranueshëm për Bankën.

3.03 Periudha e tërheqjes. Data e mbylljes e përmendur në shkronjën “c” të seksionit 3.06 të kushteve standarde është 28 dhjetor 2012.

Neni 4

Hyrja në fuqi

4.01 Kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi derisa Bankës Botërore t’i jenë siguruar të dhëna të pranueshme se kushtet e përcaktuara më poshtë janë përmbushur.

- a) MOG i pranueshëm për Bankën Botërore, është miratuar nga marrësi.

4.02 Përveç kur marrësi dhe Banka Botërore bien dakord ndryshe, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi datën në të cilën Banka Botërore i dërgon marrësit njoftim për pranimin nga ana e saj të provave të kërkuara sipas seksionit 4.01 (data e hyrjes në fuqi). Nëse përpara datës së hyrjes në fuqi, ka ndodhur një ngjarje që do t’i kishte dhënë Bankës Botërore të drejtën për të pezulluar të drejtën e marrësit për të bërë tërheqje nga llogaria e grantit, nëse kjo Marrëveshje do të kishte qenë në fuqi, Banka Botërore mund të shtyjë dërgimin e njoftimit të përmendur në këtë seksion derisa kjo ngjarje (ose disa ngjarje) të ketë (kenë) pushuar së ekzistuari.

Neni 4

Përfaqësuesi i marrësit, adresat

4.01 Përfaqësuesi i marrësit. Përfaqësuesi i marrësit i përmendur në seksionin 7.02 të kushteve standarde, është Ministri i Financave.

4.02 Adresa e marrësit. Adresa e marrësit e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde është:

Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Nr. 4, Tiranë, Shqipëri
Tel: 355-4-222-8405
Faks: 355-4-222-8494

4.03 Adresa e Bankës Botërore. Adresa e Bankës Botërore e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde është:



International Bank for Reconstruction and Development
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America
Telegraf: INTBAFRAD, Washington, D.C.
Teleks: 248423 (MCI) or; 64145 (MCI)
Faks: 1-202-477-6391

VENDIM
Nr. 443, datë 11.7.2012

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF 011176, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM/SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM, SI
ADMINISTRATORE TË FONDIT TË BESIMIT MULTIDONATOR PËR LEHTËSIMIN E
QEVERISJES ME PARTNERITET, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “MBËSHJETJA
PËR RRIJTJEN E SIGURISË SË SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK NË
SHQIPËRI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Për miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF 011176, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, si administratore të Fondit të Besimit Multidonator për lehtësimin e qeverisjes me partneritet, për financimin e projektit “Mbështetja për rritjen e sigurisë së sistemit të prokurimit elektronik në Shqipëri”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Banka Botërore
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

1818 H Street N.W.
Washington, D.C. 20433
U.S.A.

(202) 477-1234
Adresa kablllore: INTBAFRAD
Adresa kablllore: INDEVAS

5 prill 2012

Z. Ridvan Bode
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Dëshmorët e Kombit
Nr. 4
Tiranë, Shqipëri

MBËSHTETJA PËR RITJEN E SIGURISË SË SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK NË
SHQIPËRI
GRANTI NR. TF011176

Shkëlqesi:

Në përgjigje të kërkesës për ndihmë financiare të bërë në emër të Shqipërisë (përfituesi), kam kënaqësinë t'iu informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqata për Zhvillim Ndërkombëtar (Banka Botërore), duke vepruar si administratore të fondeve të grantit të ofruara nga donatorë të ndryshëm (donator(ë)) nën fondin e besimit me shumë donatorë për lehtësimin e qeverisjes me partneritet, propozon t'i japë përfituesit në përfitim të Agjencisë së Prokurimit Publik, një grant në një shumë që nuk kalon njëqind mijë dollarë amerikanë (100,000 US\$) (granti) në bazë të termave dhe kushteve të parashtruara ose të përmendura në këtë letër-marrëveshjeje (Marrëveshja), e cila përfshin aneksin e bashkëlidhur, për të asistuar në financimin e projektit të përshkruar në aneks (projekti).

Ky grant financohet nga fondi i lartpërmendur i besimit për të cilin Banka Botërore merr kontribute periodike nga donatorët. Në pajtim me seksionin 3.02 të kushteve standarde (sipas përcaktimit në aneksin e kësaj Marrëveshjeje), detyrimet për pagesë të Bankës Botërore në lidhje me këtë Marrëveshje kufizohen në shumën e fondeve të vëna në dispozicion asaj nga donatorët sipas fondit të lartpërmendur të besimit, dhe e drejta e përfituesit për të tërhequr shumën e grantit i nënshtrohet disponueshmërisë së këtyre fondeve. Për rrjedhojë, nëse për ndonjë arsye donatori/ndonjë donator anulon ose nuk mund të paguajë kontribute sipas fondit të besimit për Bankën Botërore, ose kur si rezultat i ndryshimeve të këmbimit valutor, shumën e fondeve të vëna në dispozicion në fondin e besimit është e pamjaftueshme për qëllimet e grantit, përfituesi do të marrë përsipër rrezikun e kësaj mungese financimi dhe Banka Botërore nuk do të ketë asnjë lloj përgjegjësie ndaj përfituesit ose palëve të treta në lidhje me shpenzimet ose detyrimet e shkaktuara nga përfituesi ose palë të treta në lidhje me këtë Marrëveshje që kalon shumën e fondeve të vëna në dispozicion Bankës Botërore nga donatorët për qëllimet e grantit.

Me anë të konfirmimit të Marrëveshjes së mëposhtme, përfituesi përfaqëson se ai është i autorizuar të lidhë këtë Marrëveshje dhe të realizojë projektin në pajtim me termat dhe kushtet e përcaktuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje.

Ju lutem konfirmoni pëlqimin e përfituesit, për sa më sipër, duke autorizuar një zyrtar të përfituesit për të nënshkruar dhe vendosur datën e kopjes së bashkëlidhur të Marrëveshjes dhe duke ia kthyer atë Bankës Botërore. Me marrjen e kopjes së kundërsigluar, kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas njoftimit nga përfituesi për përfundimin e procedurave të tij të brendshme, megjithatë me kusht që oferta e kësaj Marrëveshjeje të konsiderohet e tërhequr nëse Banka Botërore nuk ka marrë kopje të kundërsigluar të Marrëveshjes dhe njoftimin përkatës brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga Banka Botërore, përveç rastit kur Banka Botërore dhe përfituesi do të kenë caktuar një datë të mëvonshme për këtë qëllim.

Me respekt
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM/SHOQATA PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR

Nga: _____

Kseniya Lvovsky
Menaxhere vendi
Zyra e Bankës Botërore
Tiranë, Shqipëri

RËNË DAKORD:
EMRI I PËRFITUESIT



Nga: _____

Përfaqësues i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

Datë: _____

Bashkëlidhur:

1. Kushtet standarde për grantet e dhëna nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme, të datës 31 korrik 2010.

2. Letër disbursimi e së njëjtës datë si kjo Marrëveshje, së bashku me udhëzimet e disbursimit të Bankës Botërore për projektet, të datës 1 maj 2006.

Granti nr. TF011176

ANEKS

Neni 1

Kushtet standarde, përkufizime

1.01 Kushtet standarde. Kushtet standarde për grantet e dhëna nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme, të datës 31 korrik 2010 (kushtet standarde), përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përkufizimet. Nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet e dhëna atyre në kushtet standarde ose në këtë Marrëveshje.

Neni 2

Zbatimi i projektit

2.01. Objektivat dhe përshkrimi i projektit. Objektivi i projektit është forcimi i sigurisë së sistemit të prokurimit elektronik në Shqipëri ndaj standardit të nevojshëm për përdorimin e tij në lidhje me prokurimin në operacionet e financuara nga Banka. Projekti përbëhet nga pjesa e mëposhtme: ofrimi i shërbimeve të konsulentëve për të projektuar dhe zhvilluar program për kodimin e të dhënave, që duhet të jetë i përputhshëm dhe i integruar me sistemin e prokurimit elektronik në Shqipëri.

2.02. Zbatimi i projektit në përgjithësi. Përfituesi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të projektit. Për këtë qëllim, përfituesi e realizon projektin nëpërmjet njësisë qendrore të financimeve dhe kontraktimeve (CFCU) në Ministrinë e Financave, në pajtim me dispozitat e: (a) Nenit II të kushteve standarde; (b) Udhëzimeve për "Parandalimin dhe luftimin e mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e IBRD-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-s", të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuar në janar 2011 (udhëzimet kundër korrupsionit); dhe (c) këtij neni II.

2.03. Vizibiliteti i donatorit dhe vizitat

a) Përfituesi merr masa ose ndihmon për marrjen e të gjitha atyre masave që Banka Botërore mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të identifikuar publikisht mbështetjen e donatorit për projektin.

b) Për qëllimet e seksionit 2.09 të kushteve standarde, përfituesi, me kërkesë të Bankës Botërore, i jep mundësinë përfaqësuesve të donatorit(ëve) të vizitojnë ndonjë pjesë të territorit të përfituesit për qëllime të lidhura me projektin.

2.04. Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i projektit

a) Përfituesi monitoron dhe vlerëson progresin e projektit dhe përgatit raportet e projektit në pajtim me dispozitat e seksionit 2.06 të kushteve standarde dhe mbi bazën e treguesit të përcaktuar më poshtë në paragrafin (b) të këtij seksioni. Çdo raport-projekt mbulon periudhën e një semestri kalendarik dhe i jepet Bankës Botërore jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

b) Treguesi i performancës, i përmendur në paragrafin (a), konsiston në sa më poshtë: sistemi i prokurimit elektronik të Shqipërisë ka garanci të mjaftueshme për të siguruar integritet të procesit të prokurimit të bazuar në kodim.

c) Përfituesi përgatit raportin përfundimtar në pajtim me dispozitat e seksionit 2.06 të kushteve standarde. Raporti përfundimtar i jepet Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së mbylljes.

2.05. Menaxhimi financiar

a) Përfituesi garanton që një sistem menaxhimi financiar të mbahet në pajtim me dispozitat e seksionit 2.07 të kushteve standarde.

b) Përfituesi garanton se raportet e ndërmjetme financiare të paaudituar për projektin të përgatiten dhe t'i jepen Bankës Botërore si pjesë e raportit të projektit jo më vonë se një muaj pas mbarimit të çdo semestri kalendarik, duke mbuluar semestrin, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

c) Përfituesit nuk do t'i kërkohet të përgatisë dhe paraqesë një raport auditimi pas përfundimit të grantit, por do t'i nënshtrohet procedurave alternative të garancisë, të cilat përfshijnë: (i) ofrimin nga përfituesi të një deklarate përfundimtare që reflekton, në lidhje me projektin, burimet dhe përdorimet e fondeve, të përgatitur në pajtim me termat e referencës të pranueshëm për Bankën; (b) rishikimin nga Banka të transaksioneve individuale, duke përfshirë ato që formojnë bazën e deklaratës së mësipërme, për të garantuar se shumtë e grantit janë përdorur për qëllimet e synuara.

2.06 Prokurimi

a) Të përgjithshme. Të gjitha shërbimet e konsulentëve të kërkuara për projektin dhe që duhet të financohen nga shumtë e grantit, prokurohen në pajtim me kërkesat e përcaktuara ose të përmendura në:

i) Seksionet I dhe IV të “Udhëzimeve: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas huave të IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-s nga huamarrësit e Bankës Botërore” të muajit janar 2011 (udhëzimet e konsulentit).

b) Përkufizimet. Termat me germa kapitale të përdorura në paragrafin e mëposhtëm të këtij seksioni për të përshkruar metoda të veçanta prokurimi ose metoda rishikimi nga Banka Botërore të kontratave të veçanta, i referohen metodës korresponduese të përshkruar në seksionet III, IV dhe V të udhëzimeve të konsulentit.

c) Metoda të veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve:

i) Metoda e mëposhtme mund të përdoret për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për këtë funksion: (a) Përzgjedhja nga një burim i vetëm i firmave konsulente.

d) Rishikim nga Banka Botërore i vendimeve të prokurimit. Ka vetëm një kontratë për këtë funksion që i nënshtrohet rishikimit paraprak nga Banka Botërore.

Neni 3

Tërheqja e shumave të grantit

3.01. Shpenzimet e pranueshme. Përfituesi mund të tërheqë shumtë e grantit në pajtim me dispozitat e: (a) Nenit III të kushteve standarde; (b) këtij seksioni; dhe (c) atyre udhëzimeve shtesë që Banka Botërore mund të përcaktojë duke njoftuar përfituesin (përfshirë “Udhëzimet e disbursimit të Bankës Botërore për projektet” të muajit maj 2006, të rishikuara herë pas here nga Banka Botërore dhe të bëra të zbatueshme për këtë Marrëveshje sipas këtyre udhëzimeve), për të financuar 100 % të shpenzimeve të pranueshme që përbëhen nga shërbimet e konsulentëve për projektimin dhe zhvillimin e një moduli për kodimin e të dhënave. Taksat janë të pranueshme për financim nga shumtë e grantit.

3.02. Kushtet e tërheqjes. Pavarësisht nga dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të bëhet asnjë tërheqje:

a) për pagesat e bëra përpara datës të kundërsiglimit të kësaj Marrëveshjeje nga përfituesi.

3.03. Periudha e tërheqjes. Data e mbylljes e përmendur në seksionin 3.06 (c) të kushteve standarde është 31 tetor 2012.



Neni 4

Përfaqësuesi i përfituesit, adresat

4.01. Përfaqësuesi i përfituesit. Përfaqësuesi i përfituesit i përmendur në seksionin 7.02 të kushteve standarde është Ministri i Financave.

4.02. Adresa e përfituesit: Adresa e përfituesit e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde është:

Z. Ridvan Bode
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Dëshmorët e Kombit
Nr. 4
Tiranë, Shqipëri

4.03. Adresa e Bankës Botërore. Adresa e Bankës Botërore e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/ Shoqata për Zhvillim Ndërkombëtar
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America

Kabllore:	Teleks:	Faks:
INTBAFRAD		
INDEVAS	248423 (MCI) ose	1-202-477-6391
Washington, D.C.	64145 (MCI)	

Banka Botërore BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM	1818 H Street N.W. Washington, D.C. 20433 U.S.A.	(202) 473-1000 Adresa kabllore: INTBAFRAD Adresa kabllore: INDEVAS
--	--	--

5 prill 2012

Shkëlqesisë së tij, Ridvan Bode
Ministër
Ministria e Financave
Tiranë, Shqipëri

I nderuar Shkëlqesi:

Mbi: Grantin nr. TF011176, projekti për mbështetjen për rritjen e sigurisë së sistemit të prokurimit elektronik në Shqipëri

Udhëzime shtesë: disbursimi

Në përgjigje referuar letër-marrëveshjes (Marrëveshja) ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore) që vepron si administratore e fondeve të grantit, të dhëna nga donatorë të ndryshëm (donatori(ët)) nën fondin e besimit me shumë donatorë për lehtësimin e qeverisjes me partneritet dhe “përfituesit” për projektin e lartpërmendur të datës 5 prill 2012. Marrëveshja parashikon se Banka Botërore mund të nxjerrë udhëzime shtesë në lidhje me tërheqjen e shumave të grantit nr. TF011176 (granti). Kjo letër (letër disbursimi) e rishikuar herë pas here përbën udhëzime shtesë.

Udhëzimet e disbursimit të Bankës Botërore për projektet, bashkëlidhur, të datës 1 maj 2006, (udhëzimet e disbursimit) (shtojca 1), janë pjesë integrale e letrës së disbursimit. Mënyra në të cilën 5962

dispozitat në udhëzimet e disbursimit zbatohen për grantin, përcaktohet më poshtë. Seksionet dhe nënseksionet në thonjëza më poshtë i referohen seksioneve dhe nënseksioneve përkatëse në udhëzimet e disbursimit dhe, nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë letër, termat me germa kapitale të përdorura kanë kuptimet e dhëna atyre në udhëzimet e disbursimit.

I. Masat e disbursimit

i) Metodatat e disbursimit (seksioni 2). Për grantin mund të përdoren metodatat e mëposhtme të disbursimit:

- Pagesa e drejtpërdrejtë

ii) Data e afatit të fundit të disbursimit (nënseksioni 3.7). Data e afatit të fundit të disbursimit është katër muaj pas datës së mbylljes (31 tetor 2012) e përcaktuar në Marrëveshjen e grantit. Çdo ndryshim në këtë datë do të njoftohet nga Banka Botërore.

iii) Kushtet e disbursimit (nënseksioni 3.8). Ju lutem referojuni kushtit të disbursimit në marrëveshjen e grantit.

II. Raportimi për përdorimin e shumave të grantit

i) Dokumentacioni mbështetës (seksioni 4). Dokumentacioni mbështetës duhet të jepet me çdo kërkesë për tërheqje, siç përcaktohet më poshtë:

- Për kërkesën për pagesë të drejtpërdrejtë: të dhënat që evidentojnë shpenzimet e pranueshme, për shembull: kopje të faturave, fatura të furnizuesve.

III. Informacion tjetër i rëndësishëm

Për informacione shtesë mbi masat e disbursimit, ju lutem referojuni manualit të disbursimit të vënë në dispozicion në faqen publike të internetit të Bankës <https://www.worldbank.org> dhe faqes së saj të sigurt të internetit “lidhja e klientit” <https://clientconnection.worldbank.org>. Kopjet e printuara vihen në dispozicion sipas kërkesës.

Nga faqja e internetit “lidhja e klientit”, do të jeni në gjendje të shkarkoni aplikime, të monitoroni në kohë reale gjendjen e përafërt të grantit dhe të nxirrni informacione në lidhje me politikën, financimin dhe prokurimin.

Nëse ende nuk e keni bërë këtë, Banka rekomandon që të regjistroheni si përdorues i faqes së internetit “lidhja e klientit” (<https://clientconnection.worldbank.org>). Nga kjo faqe interneti do të shkarkoni aplikime, të monitoroni në kohë reale gjendjen e përafërt të grantit dhe të nxirrni informacione në lidhje me politikën, financimin dhe prokurimin. Të gjithë zyrtarëve të përfituesit të autorizuar për të nënshkruar dhe dorëzuar aplikime me mjete elektronike u kërkohet të regjistrohen në lidhjen e klientit përpara kryerjes së dorëzimit elektronik. Për më shumë informacion rreth faqes së internetit dhe masave të regjistrimit, ju lutem kontaktoni Bankën me e-mail në clientconnection@worldbank.org.

Nëse keni pyetje në lidhje me sa më sipër, ju lutem kontaktoni zyrtarin financiar në adresën loa-tf@worldbank.org, duke përdorur referencën e mësipërme.

Me respekt

Nga _____

Kseniya Lvovsky

Menaxhere vendi

Zyra e Bankës Botërore

Tiranë, Shqipëri



SHTOJCA 2

[Kokë e letrës]
Ministria e Financave
[Adresa postare]
[Qyteti] [Vendi]

[DATË]

Grupi i Bankës Botërore
Rruga: “Dëshmorët e 4 Shkurtit”
Vila nr. 34
Tiranë, Shqipëri
Në vëmendje të: Kseniya Lvovsky
E nderuar Kseniya Lvovsky:

Granti nr. TF-11176 Projekti për mbështetjen për rritjen e sigurisë së sistemit të prokurimit elektronik në Shqipëri

I referohem letër-marrëveshjes (Marrëveshja) ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore) që vepron si administratore e fondeve të grantit, të dhëna nga donatorë të ndryshëm (donatori(ët)) nën fondin e besimit me shumë donatorë për lehtësimin e qeverisjes me partneritet dhe “përfituesit” për projektin e lartpërmendur të datës 5 prill 2012, që ofron grantin e mësipërm. Për qëllimet e seksionit 3.04 (b) të kushteve standarde, të përcaktuara në Marrëveshje, çdokush prej personave, nënshkrimet model të vërtetuara të të cilëve shfaqen më poshtë, autorizohet në emër të përfituesit të nënshkruajë aplikimet për tërheqje dhe aplikimet për një angazhim të veçantë financiar sipas këtij granti.

Për qëllim të dorëzimit të aplikimeve pranë Bankës Botërore, secili prej personave nënshkrimet model të vërtetuara të të cilit shfaqet më poshtë, autorizohet në emër të përfituesit, duke vepruar individualisht ose bashkërisht, që të dorëzojë aplikime dhe prova mbështetëse, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara nga Banka Botërore.

Kjo konfirmon se përfituesi autorizon këta persona të pranojnë pajisjet e posaçme dhe të dorëzojnë aplikimet dhe dokumentet mbështetëse Bankës Botërore me mjete elektronike. Duke pranuar plotësisht se Banka Botërore do të bazohet në këto përfaqësime dhe garanci, duke përfshirë pa kufizim, përfaqësimet dhe garancitë në përmbajtje të termave dhe kushteve të përdorimit të aparateve të identifikimit të sigurt në lidhje me përdorimin e mjeteve elektronike për përpunimin e aplikimeve dhe dokumentacionit mbështetës (termat dhe kushtet e përdorimit të pajisjeve të posaçme), përfituesi përfaqëson dhe i garanton Bankës Botërore se ai do t'i dorëzojë secilit prej këtyre personave një kopje të termave dhe kushteve të përdorimit të pajisjeve të posaçme dhe do të marrë masa që këta persona t'i respektojnë këta terma dhe kushte.

Ky autorizim zëvendëson çdo autorizim aktualisht në të dhënat e Bankës në lidhje me këtë Marrëveshje.

[Emri], [Pozicioni]
[Emri], [Pozicioni]
[Emri], [Pozicioni]

Nënshkrimi model: _____
Nënshkrimi model: _____
Nënshkrimi model: _____

Me respekt
/nënshkrimi/

[Pozicioni]

SHTOJCA 3

TERMAT DHE KUSHTET E PËRDORIMIT TË APARATEVE PËR IDENTIFIKIMIN E SIGURT NË LIDHJE ME PËRDORIMIN E MJETEVE ELEKTRONIKE PËR PËRPUNIMIN E APLIKIMEVE DHE DOKUMENTACIONIT MBËSHTETËS 20 JANAR 2010

Banka Botërore (Banka)¹ do të ofrojë aparate për identifikim të sigurt (pajisje të posaçme) për të lejuar huamarrësin² të dorëzojë aplikime për tërheqje dhe aplikime për angazhime të veçanta financiare sipas Marrëveshjes (eve) dhe dokumentacion mbështetës (këto aplikime dhe dokumentacion mbështetës bashkërisht të përmendura në këta terma dhe kushte të përdorimit si aplikime) për Bankën në formë elektronike, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara në të.

A. Identifikimi i përdoruesve

1. Huamarrësit do t'i kërkohet të identifikojë në një letër të plotësuar të nënshkruesit të autorizuar (ASL), të dorëzuar dhe të marrë sipas rregullave nga Banka, çdo person që do të autorizohet të dorëzojë aplikime. Banka do t'i ofrojë pajisje të posaçme çdo personi të identifikuar në ASL (nënshkruesi), siç parashikohet më poshtë. Gjithashtu, huamarrësi do të njoftojë menjëherë Bankën nëse një nënshkrues nuk është më i autorizuar nga huamarrësi që të veprojë si nënshkrues.

2. Çdo nënshkrues duhet të regjistrohet si përdorues në faqen e internetit të lidhjes së klientit të Bankës (CC) (<https://clientconnection.worldbank.org>) përpara dorëzimit të pajisjeve të posaçme. Regjistrimi në CC do të kërkojë që nënshkruesi të krijojë një fjalëkalim CC (fjalëkalimi CC). Nënshkruesi nuk ia zbulon asnjë personi fjalëkalimin e tij/të saj CC ose nuk e ruan ose regjistron fjalëkalimin CC në formë me shkrim ose në ndonjë formë tjetër. Pas regjistrimit si përdorues CC, nënshkruesit do t'i jepet një emër unik identifikues llogarie.

B. Shpërndarja, caktimi i inicialeve dhe kthimi i pajisjeve të posaçme

1. Banka do t'i dorëzojë fizikisht një pajisje të posaçme çdo nënshkruesi në një mënyrë që duhet të përcaktohet nga Banka dhe të jetë e pranueshme për të.

2. Në kohën e dorëzimit të një pajisjeje të posaçme për një nënshkrues, nënshkruesi do të marrë një kopje të këtyre termave dhe kushteve të përdorimit me qëllim caktimin e inicialeve të pajisjes së posaçme.

3. Banka do të verifikojë se pajisjet e posaçme, fjalëkalimi i përkohshëm dhe termat dhe kushtet e përdorimit i janë dorëzuar dhe janë marrë sipas rregullave nga përdoruesi CC.

4. Menjëherë pas marrjes së pajisjes së posaçme dhe termave dhe kushteve të përdorimit, nënshkruesi do të futet në CC, duke përdorur emrin e tij/të saj të llogarisë dhe fjalëkalimin CC dhe do të regjistrojë pajisjet e posaçme të tij/saj dhe caktojë një numër identifikimi personal (PIN), që duhet të përdoret në lidhje me përdorimin e pajisjes së posaçme të tij/saj, pas së cilës pajisja e posaçme do t'i nënshtrohet caktimit të inicialeve për përdorim nga nënshkruesi vetëm për qëllimet e dorëzimit të aplikimeve. Pas caktimit të inicialeve të pajisjes së posaçme, nënshkruesi do të jetë një "përdorues i pajisjes së posaçme". Banka do të ruajë në bazën e saj të të dhënave një llogari përdoruesi (llogaria) për secilin përdorues të pajisjes së posaçme, për qëllime të menaxhimit të pajisjeve të posaçme të përdoruesit të pajisjes së posaçme. As huamarrësi, as përdoruesi i pajisjes së posaçme nuk do të ketë akses në llogari.

5. Përpara përdorimit fillestar të pajisjes së posaçme nga përdoruesi i pajisjes së posaçme për dorëzimin e aplikimeve, huamarrësi do të garantojë se përdoruesi i pajisjes së posaçme ka marrë materiale trajnuese, të ofruara nga Banka në përdorimin e pajisjes së posaçme.

6. Pajisjet e posaçme do t'i kthehen menjëherë Bankës me kërkesë të kësaj të fundit.

C. Menaxhimi i pajisjeve të posaçme

¹ "Banka" përfshin IBRD-në dhe IDA-n.

² "Huamarrësi" përfshin huamarrësin e një huaje të IBRD-së, kredie të IDA-së ose huaje për shërbimin e përgatitjes së projektit dhe përfituesin e një granti.



1. Pajisjet e posaçme do të mbeten pronë e Bankës.
2. Përdorimi i pajisjeve të posaçme kufizohet rreptësisht në përdorimin për dorëzimin e aplikimeve nga përdoruesi i pajisjes së posaçme në mënyrën e përcaktuar nga Banka në Marrëveshje (t) dhe në këta terma dhe kushte. Ndalohet çdo përdorim tjetër i pajisjes së posaçme.
3. Banka nuk merr përsipër asnjë lloj përgjegjësie ose detyrimi për ndonjë keqpërdorim të pajisjes së posaçme nga përdoruesi i pajisjes së posaçme, përfaqësues të tjerë të huamarrësit ose palë të treta.
4. Huamarrësi merr përsipër të garantojë dhe përfaqëson, dhe i garanton Bankës (ndërsa ky përfaqësim dhe kjo garanci mbështetet shprehimisht nga Banka në dorëzimin e një pajisjeje të posaçme për çdo përdorues të pajisjes së posaçme), që çdo përdorues i pajisjes së posaçme i siguron, kupton dhe respekton këta terma dhe kushte përdorimi, duke përfshirë pa kufizim sa më poshtë:
 - Sigurimi
 - 4.1 Përdoruesi i pajisjes së posaçme nuk i zbulon asnjë personi PIN-in e tij/të saj, ose nuk ruan apo regjistron PIN-in në një formë me shkrim ose në ndonjë formë tjetër.
 - 4.2 Përdoruesi i pajisjes së posaçme nuk lejon asnjë person tjetër të shfrytëzojë një pajisje të posaçme për t'i dorëzuar Bankës një aplikim.
 - 4.3 Kur nuk përdor sistemin, përdoruesi i pajisjes së posaçme duhet të dalë gjithmonë nga CC. Mosdalja në mënyrën e duhur mund të krijojë një rrugë të pambrojtur në sistem.
 - 4.4 Nëse përdoruesi i pajisjes së posaçme mendon se një palë e tretë ka mësuar PIN-in e tij/të saj, ose ka humbur pajisjen e posaçme të tij/saj, ai/ajo do të njoftojë menjëherë në adresën clientconnection@worldbank.org
 - 4.5 Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Bankën në adresën clientconnection@worldbank.org në lidhje me çdo pajisje të posaçme të humbur, të vjedhur ose të cenuar, dhe merr hapa të tjerë të arsyeshëm që këto pajisje të posaçme të çaktivizohen menjëherë.
 - Kujdesi për pajisjet e posaçme
 - 4.6 Pajisjet e posaçme përmbajnë instrumentin sensitiv dhe të sofistikuar dhe, rrjedhimisht, duhet të trajtohen me kujdesin e duhur dhe nuk duhet të zhyten në lëngje, nuk duhet të ekspozohen në temperatura ekstreme, nuk duhet të shtypen ose përkulen. Gjithashtu, pajisjet e posaçme duhet të mbahen më shumë se pesë (5) cm nga aparatet që lëshojnë rrezatim elektromagnetik (EMR), si për shembull: telefona celulare, PDA për mundësimin e telefonave, *smart phones* dhe aparate të tjera të ngjashme. Pajisjet e posaçme duhet të mbahen dhe ruhen të ndara nga ndonjë aparat EMR. Në rreze të ngushtë (më pak se 5 cm), këto aparate mund të prodhojnë nivele të larta EMR, që mund të shkaktojnë interferenca në funksionimin e duhur të pajisjeve elektronike, duke përfshirë pajisjen e posaçme.
 - 4.7 Pa u shmangur nga këta terma dhe kushte përdorimi, udhëzime të tjera teknike mbi përdorimin dhe kujdesin e duhur, pajisjet e posaçme janë të disponueshme në adresën <http://www.rsa.com>
5. Zëvendësimi
 - 5.1 Pajisjet e posaçme të humbura, të dëmtuara, të cenuara (në lidhje me pikat 4,5 më lart) ose të shkatërruara do të zëvendësohen me shpenzime të huamarrësit.
 - 5.2 Banka rezervon të drejtën, me diskrecionin e saj të vetëm, të mos zëvendësojë pajisjen e posaçme në rast keqpërdorimi ose të mos riaktivizojë një llogari të përdoruesit të pajisjes së posaçme.
6. Rezervimi i së drejtës për çaktivizimin e pajisjes së posaçme
 - 6.1 Huamarrësi rezervon të drejtën për të anuluar autorizimin e një përdoruesi të pajisjes së posaçme, për të përdorur një pajisje të posaçme për çdo lloj arsyeje.
 - 6.2 Banka rezervon të drejtën, me diskrecionin e saj të vetëm, për të çaktivizuar përkohësisht ose në mënyrë të përhershme një pajisje të posaçme, për të çaktivizuar një llogari të përdoruesit të pajisjes së posaçme ose të dyja.

VENDIM
Nr. 446, datë 11.7.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 532, DATË 7.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONE USHTARAKE NË SHTABE TË NDRYSHME NË AFGANISTAN”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 532, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikat 1.1, 1.2 dhe 1.5 fjalët “...2 (dy) vjet...” zëvendësohen me “...në 31 dhjetor 2013,...”.
 - b) Në pikën 1.3 fjalët “...2 (dy) vjet...” zëvendësohen me “...në 31 gusht 2012,...”.
 - c) Në pikën 1.4 fjalët “...2 (dy) vjet...” zëvendësohen me “...në 30 prill 2013,...”.
 - ç) Në pikën 1.6 fjalët “...2 (dy) vjet...” zëvendësohen me “...në 31 korrik 2012,...”.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.
3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 447, datë 11.7.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 197, DATË 16.3.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK NDËRKOMBËTAR KFOR, KOSOVË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr. 197, datë 16.3.2011 të Këshillit të Ministrave, numri 5 (pesë) ndryshohet dhe bëhet “10 (dhjetë)”.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.



3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 448, datë 11.7.2012

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT DHE TË EMËRTIMIT TË
INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË “NEW YORK UNIVERSITY OF
TIRANA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, 5, 40 e 43 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit të institucionit privat të arsimit të lartë “New York University of Tirana” nga shkollë e lartë universitare në universitet, me emërtimin “Universiteti i New York-ut në Tiranë (University of New York, Tirana)”.

2. Ky institucion privat i arsimit të lartë ruan akreditimin institucional dhe të programeve të studimit, të fituar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 449, datë 11.7.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË
KABINETEVE NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS,
ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË
PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË
VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 2/1, që përmendet në shkronjën “c” të pikës 2 të vendimit nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare të këtij vendimi të fillojnë nga data 1 janar 2012.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 2/1

POZICIONI	KUALIFIKIMI/GRADA/TITULLI SHKENCOR	SHTESA (LEKË/MUAJ)
Zëvendësministër	Profesor	30.000
Drejtor i Kabinetit të Presidentit/Kryetarit të Kuvendit/Kryeministrit/Zëvendëskryeministrit	Profesor i asociuar	25.000
Këshilltar i Presidentit/Kryetarit të Kuvendit/Kryeministrit/Zëvendëskryeministrit		
Ndihmës i Presidentit/Kryetarit të Kuvendit/Kryeministrit		
Sekretar i Përgjithshëm		
Prefekt		
Titullar i institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës		
Anëtar i organeve kolegjiale drejtuese me kohë të plotë të institucioneve të pavarura të përcaktuara në pikën 1/1 të vendimit		
Ndihmës i Zëvendëskryeministrit	- Studime postmaster sipas përcaktimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në vendet e përcaktuara sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë të Financave;	20.000
Drejtor Kabineti i Ministrit/titullarëve të institucioneve të pavarura të përcaktuar në pikën 1/1 të vendimit	- të barasvlershme me studimet postmaster në vendet e përcaktuara sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë të Financave;	
Këshilltar i Ministrisë/titullarëve të institucioneve të pavarura të përcaktuar në pikën 1/1 të vendimit	- diplomat master të lëshuara në sistemin anglo-sakson;	
Zëvendëstitullar i institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës	- diplomat master të fituara në përfundim të programeve universitare që realizohen me jo më pak se 60 kredite ECTS dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit akademik në një nga vendet e listës bashkëlidhur udhëzimit të përbashkët vetëm për nëpunësit e diplomuar më parë në programet e studimeve universitare, që kanë zgjatje minimumi 4 vite akademike (8 semestra) para zbatimit të sistemit të Bolonjës dhe nëpunësit që kanë përfunduar programet e studimeve të ciklit të dytë sipas sistemit të Bolonjës.	
Nënprefekt		
Drejtor departamenti		
Drejtor i Përgjithshëm		
Drejtor drejtorie dhe pozicionet e veçanta të punës të kategorizuar në kategorinë II-b, ose më lart, sipas këtij vendimi, në institucionet e përcaktuara në pikën 1/1 të vendimit		
	Doktor i shkencave	20.000
	Doktor i shkencave në vendet e përcaktuara sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë të Financave	25.000



VENDIM
Nr. 450, datë 11.7.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 289, DATË 17.5.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË
LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONA VE/NDËRTIMEVE
INFORMALE (ALUIZNI)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 46 të ligjit nr. 9482, datë 16.2.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 289, datë 17.5.2006 të Këshillit të Ministrave, bëhet ky ndryshim:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. ALUIZNI ka Drejtorinë e Përgjithshme në Tiranë dhe:

a) 4 (katër) drejtori në qarkun e Tiranës;

b) 3 (tre) drejtori në qarkun e Vlorës;

c) 2 (dy) drejtori në qarkun e Elbasanit;

ç) 3 (tre) drejtori në qarkun e Fierit;

d) 2 (dy) drejtori në qarkun e Durrësit;

dh) 2 (dy) drejtori në qarkun e Korçës;

e) nga 1 (një) drejtori për qarqet: Berat, Gjirokastrë, Dibër, Kukës, Lezhë dhe Shkodër.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 458, datë 25.7.2012

**PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË KRYETARIT TË KOMUNËS LENIE,
Z. ASTRIT BICI**

Në mbështetje të neneve 100 dhe 115 pika 1 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a” të nenit 42 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkarkimin nga detyra, për shkelje të rënda të ligjit, të kryetarit të komunës Lenie, z. Astrit Bici.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 462, datë 11.7.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1188, DATË 20.8.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR IMPORTIMIN, TREGTIMIN,
TRANSPORTIN, RUAJTJEN, PËRDORIMIN DHE ASGJËSIMIN E PRODUKTEVE PËR
MBROJTJEN E BIMËVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit nr. 9362, datë 24.3.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1188, datë 20.8.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Emërtimet e përmendura kudo në këtë vendim ndryshohen, si më poshtë vijon:

a) Emërtimi “Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (DRBUMK)” zëvendësohet me “Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), me përjashtim të krerëve V dhe VI;

b) Emërtimi “Inspektorati i Mbrojtjes së Bimëve të DRBUMK-së”, zëvendësohet me “Sektori i mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore të AKU-së”, me përjashtim të krerëve V dhe VI;

c) Në kreun V, emërtimi “Inspektorati i Mbrojtjes së Bimëve pranë DRBUMK-së”, zëvendësohet me “Sektori i shërbimit këshillimor pranë Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë”;

ç) Në krerët V dhe VI emërtimi “Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (DRBUMK)” zëvendësohet me “Drejtoria Rajonale e Bujqësisë (DRB) dhe emërtimi “Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit” zëvendësohet me “Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë”.

d) Në pikën 6 të kreut I, termi “ambalazhim” zëvendësohet me “ambalazh”.

2. Pikat 3, 4 të kreut I; pikat 2, 4, 6, 7 dhe 11 të kreut II; pikat 2, 4, 6, 7, 8 dhe 14 të kreut III; pikat 3, 4, 7, 12, 13, 14 dhe 15 të kreut X, si dhe shtojcat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6, bashkëlidhur vendimit në fuqi, shfuqizohen.

3. Në kreun II bëhen këto ndryshime:

a) Titulli “Importimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve” ndryshohet e zëvendësohet me “Tregtimi me shumicë i produkteve për mbrojtjen e bimëve”.

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Aktiviteti i tregtimit me shumicë të PMB-ve ushtrohet vetëm nga persona të pajisur me licencë për tregtim me shumicë, të lëshuar sipas legjislacionit në fuqi për lejet dhe licencat, pas përmbushjes së kushteve të mëposhtme:

a) Personi i interesuar ose personi i punësuar prej tij të jetë i diplomuar në fushën e agronomisë;

b) Vendndodhja e magazinës së tregtimit me shumicë të jetë miratuar sipas kushteve të pikës 5 të kreut IV të vendimit nr. 1188, datë 20.8.2008 të Këshillit të Ministrave;

c) Kushtet e magazinimit të garantojnë në çdo kohë shëndetin dhe sigurinë e personelit të punësuar;

ç) Të jetë siguruar konfirmimi shëndetësor nga organet e shëndetësisë se personeli i punësuar është i aftë të punojë me PMB-të”.

c) Në pikat 5, 8 dhe 9, fjalët “... leja e importit ...” zëvendësohen me “... licenca e tregtimit me shumicë ...”.

ç) Shkronja “b” e pikës 8, shfuqizohet, ndërsa shkurtimi i emërtimit “SPMB” zëvendësohet me “AKU”.

d) Në pikën 10 fjalët “... jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë ...” zëvendësohen me “... jo më vonë se 5 (pesë) ditë ...”.



4. Në kreun III bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i kreut “Tregtimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve” ndryshohet dhe zëvendësohet me “Tregtimi me pakicë i produkteve për mbrojtjen e bimëve” dhe kudo në këtë kre termi “tregtimi” zëvendësohet me “tregtimi me pakicë”, ndërsa fjalët “leja e tregtimit” zëvendësohen me “licenca e tregtimit me pakicë”.

b) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Aktiviteti i tregtimit me pakicë të PMB-ve ushtrohet vetëm nga persona të pajisur me licencë për tregtim me pakicë, të lëshuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lejet dhe licencat, pas përmbushjes së kushteve të mëposhtme:

a) Personi i interesuar ose personi i punësuar prej tij të jetë i diplomuar në fushën e agronomisë;

b) Vendndodhja e objektit të tregtimit me pakicë të jetë miratuar sipas kushteve të pikës 9 të kreut IV të vendimit nr. 1188, datë 20.8.2008 të Këshillit të Ministrave;

c) Kushtet e tregtimit të garantojnë në çdo kohë shëndetin dhe sigurinë e personelit të punësuar;

ç) Të jetë siguruar konfirmimi shëndetësor nga organet e shëndetësisë se personeli i punësuar është i aftë të punojë me PMB-të.”.

5. Pika 3 e kreut IV, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Magazinat ndërtohen larg shkollave, shtëpive, spitaleve, qendrave tregtare, magazinave ushqimore, për njerëz dhe kafshë, pikave të karburanteve (për PMB-të e ndezshme) dhe fabrikave të përpunimit të ushqimeve, si dhe larg ujërave të rrjedhshme dhe baseneve ujore. Këto magazina rrethohen në një lartësi 2 metër. Rrethimi është 3 metër larg ndërtesës së magazinës. Jashtë rrethimit, rreth e qark tij, bëhet një kanal, me parete anësore të betonuara, i thellë një metër dhe i gjerë jo më pak se 50 cm.”.

6. Në pikën 2 të kreut VIII, fjalët “... importuesit e PMB-ve ...” zëvendësohen me “... personat e pajisur me licencë për tregtim me shumicë dhe/ose me pakicë ...”.

7. Në kreun IX, të gjitha pikat nga 1 deri në 7 zëvendësohen me paragrafin, me këtë përmbajtje:

“Riciklimi i ambalazheve të produkteve për mbrojtjen e bimëve kryhet duke u bazuar në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, si dhe në vendimin nr. 177, datë 6.3.2012 të Këshillit të Ministrave “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”.”.

8. Në kreun X bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën “b” të pikës 1, fjalët “... kur ata e shohin të arsyeshme një gjë të tillë ...” zëvendësohen me “... sipas një programi vjetor të monitorimit të tyre ...”.

b) Pikat 5 dhe 11 ndryshohen si më poshtë vijon:

“5. Marrja e mostrave dhe analizimi i tyre kryhen sipas pikave 1, 2, 3, 4 dhe 5 të nenit 38 të kreut V të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

...

11. Në rast bllokimi sipas shkronjës “a” të pikës 10 të këtij kreu, kryhet asgjësimi sipas pikës 2 të kreut VIII të vendimit nr. 1188, datë 20.8.2008 të Këshillit të Ministrave.

II. AKU-ja ka për detyrë të informojë me shkrim SPMB-në:

a) brenda muajit mars të çdo viti, për sasinë dhe cilësinë e secilit PMB, që është hedhur në treg, si dhe është përdorur gjatë vitit të mëparshëm kalendarik;

b) për probleme të veçanta, që kanë lidhje me monitorimin e PMB-ve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 463, datë 18.7.2012

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1351, DATË 3.10.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KËRKESAT TEKNIKE
METROLOGJIKE TË INSTRUMENTEVE MATËSE LIGJËRISHT TË KONTROLLUARA"**

Në mbështetje të neneve 100 dhe 119 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 18 të ligjit nr. 9875, datë 14.2.2008 "Për metrologjinë", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pjesës X të rregullores së miratuar me vendimin nr. 1351, datë 3.10.2008 të Këshillit të Ministrave, shtohen pjesët XI "Radarët e matjes së shpejtësisë" dhe XII "Analizuesit e pranisë së alkoolit në frymënxjerrjen e drejtuesve të automjeteve (analizuesit e alkoolit)", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PJESA XI. RADARËT E MATJES SË SHPEJTËSISË

Përkufizime dhe përcaktime

Kërkesat teknike-metrologjike, të renditura në vijim, zbatohen për radarët e matjes së shpejtësisë së automjeteve nga policia. Radari i matjes së shpejtësisë është projektuar për të kontrolluar shpejtësinë e automjeteve nëpërmjet rripodhimit (rivendosjes) së efektit Doppler.

Kërkesa teknike-metrologjike

1.1 Konstruktimi i radarëve të shpejtësisë siguron individualizimin e automjetit, shpejtësia e të cilit është matur, duke përfshirë dhe lëvizjen në të njëjtën kohë të dy ose tri automjeteve, kur ato janë duke kaluar ose kur radari i shpejtësisë është i montuar në një automjet që lëviz.

1.2 Nëse radari i shpejtësisë nuk është i përshtatshëm për plotësimin e kësaj kërkesë, ai duhet të bëjë të pavlefshëm rezultatet e vetë matjeve të tij kur dy automjetet kalojnë njëkohësisht nëpër tufën e rrezatimit, me shpejtësi të ndryshme.

